



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçilane
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 38 paragrafi 1.4, në nenin 46 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 29.02.2016 miratoi këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016

1. Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2014 dhe 2015 në vitin fiskal 2016.
2. Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2014 dhe 2015, në vitin fiskal 2016 barten sipas tabelës e cila është e bashkangjitur këtij.
3. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 016-19882
Gjilan, më 29.02.2016

Kryesuesja e kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi